



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

**NJOFTIM PËR MEDIAT**

**1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve **Engjell Cara, Limon Shala, Fatmir Thaçi, Florant Saraçi** dhe **Shkëlqim Hoxha**”.

**2.** Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjyimit të shkurtuar. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtaret Atalanta Zeqiraj, Flora Hajredinaj dhe Irena Gjoka, me vendimin nr. **10**, datë **06.02.2026** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Limon Shala**, për veprën penale “*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*”, e kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, të parashikuar nga nenet 328, 25 dhe 50 germa “h” të Kodit Penal, dhe bazuar në këtë dispozitë dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim burgim.
  - Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3 për të pandehurin **Limon Shala** dhe dënimin e tij përfundimisht me 1 (një) vit burgim.
  - Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe vënien në provë të të pandehurit **Limon Shala**, për një afat prej 2 (dy) vjetësh, me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës.
- 2.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatmir Thaçi** për veprën penale “*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*”, e kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, të parashikuar nga nenet 328, 25 dhe 50 germa “h” të Kodit Penal dhe bazuar në këtë dispozitë dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
  - Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri **Fatmir Thaçi** me 1 (një) vit burgim.
  - Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe vihet në provë i pandehuri **Fatmir Thaçi** për një afat prej 2 (dy) vjetësh, me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës.
- 3.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Engjell Cara** për veprën penale “*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*”, e kryer në bashkëpunim, më shumë se njëherë të parashikuar nga nenet 328, 25

dhe 50/h të Kodit Penal, dhe bazuar në këtë dispozitë dënimit e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me me 1/3, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri **Engjell Cara** me 1(një) vit burgim.
  - Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe vënia në provë e të pandehurit **Engjell Cara** për një afat prej 2 (dy) vjetësh, me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës.
- 4.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Florant Saraçi** për veprën penale “*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*”, e kryer në bashkëpunim, më shumë se njëherë të parashikuar nga nenet 328, 25 dhe 50/h të Kodit Penal, dhe bazuar në këtë dispozitë dënimit e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri **Florant Saraçi** me 1(një) vit burgim.
  - Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe vënien në provë të të pandehurit **Florant Saraçi** për një afat prej 2 (dy) vjetësh, me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës.
- 5.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Shkëlqim Hoxha** për veprën penale “*Moskallëzimi i krimi*”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe bazuar në këtë dispozitë dënimit e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri **Shkëlqim Hoxha**, me 4 (katër) muaj burgim.
  - Bazuar në nenin 63 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin **Shkëlqim Hoxha** dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për të përmbushur një punë në interes publik.
  - I pandehuri **Shkëlqim Hoxha**, urdhërohet të kryejë 60 (gjashtëdhjetë) orë punë në interes publik, brenda një afati 6 (gjashtë) muaj.
  - Urdhërohet i pandehuri **Shkëlqim Hoxha** të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës.
- 6.** Kthimin e aparateve celulare të sekuestruar shtetasve L. Shala, F.Thaci, dhe E.Cara.
- 7.** Shpenzimet procedurale të kryera gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit, ju ngarkohen solidarisht të pandehurve.
- 8.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

**Tiranë, më datë 06.02.2026**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**